



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA	REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
02/Nr. Prot.	01-180-3890
Nr. Ifaq.	1
Data	07/05/2024



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/78

Datë: 07.05.2024

Në bazë të nenit 16, paragrafi. 1, pika 2.5, nen 73, përfundimi në rastet e përcaktuara nga ligji, pika 1.4 plotësohet mosha për pensionim të Ligjit për Zyrtarët Publikë, Nr. 08/L-197, nenit 58 paragrafi (g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); nenit 42 paragrafi (i) dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, Kryetari i Komunës me datë 07.05.2024 merr ketë:

V E N D I M

PËR PERFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS PËR SHKAK TË ARRITJES SE MOSHËS PËR PENSIONIM TË NËPUNËSIT CIVIL

Nëpunësi: **Zenel Gjota** i sistemuar ne vendin e punës: Zyrtar i të hyrave në kuadër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa i **PERFUNDON** marrëdhënia e punës me datë: 01.05.2024, për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare pensionim.

Përfundimi i marrëdhënies së punës, bëhet konform dispozitave të Ligjit, të lartë cekur pasi qe i njëjtë i plotëson kriteret e parapara me ligj.

Arsyetim

Duke marrë parasysh faktin që nëpunësi **Zenel Gjota** i sistemuar ne vendin e punës: Zyrtar i të hyrave në kuadër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, ka arritë moshën 65 vjeçare me datë: 01.05.2024, në mbështetje të Ligjit të lartë cekur, si në hyrje të këtij Vendimi dhe të dhënavë nga dosja personale, konstatojm se janë plotësuar të gjitha kushtet për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Andaj u vendos si në Diapositiv të këtij Vendimi.


Vendimi u dorëzohet:

- Nëpunësit që Pensionohen;
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;
- Zyres së personelit;
- Arkivi i Komunës.





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK



02/Nr. Prot. 1-100/4051
Nr. i faq. 1
Data 10/05/2024

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr.01/79
Datë: 10.05.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); dhe nenit 43 dhe nenit 7 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, Ligjit për Vula ne Institucionet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-054, Kryetari i Komunës me datë: 10.05.2024, nxjerr ketë:

V E N D I M

PËR AUTORIZIMIN E PËRDORIMIT TË VULAVE TË KOMUNËS SË JUNIKUT

- I. Me ketë vendim autorizohet Drejtori i Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit për përdorimin e vulave të bibliotekës komunale, si në vijim:
 1. Drejtori i Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit – z.Xhavit Velijaj, Vula rrethore dhe vula katrore e bibliotekës komunale “Din Mehmeti”.
- II. I autorizuari obligohet ti përdorë vulat konform Ligjit për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës nr.03/L-054 në të kundërtën bartë përgjegjësi për keqpërdorim.
- III. Ky Vendimi hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me ketë vendim të njoftohet:

1. I autorizuari,
2. Arkivi komunal.





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK



02/Nr. Prot.

1-180/4052

Nr. ifaq.

10/05/2024

Data

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/80

Datë: 10.05.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligi Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); dhe nenit 43 dhe nenit 7 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, Ligjit për Vula ne Institucionet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-054, Kryetari i Komunës me datë: 10.05.2024, nxjerr ketë:

V E N D I M

PËR AUTORIZIMIN E PËRDORIMIT TË VULAVE TË KOMUNËS SË JUNIKUT

- I. Me këtë vendim autorizohet Drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale për përdorimin e vulave të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, si në vijim:
 - I. Drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale – z.Fatos Shala, Vula rrëthore dhe vula katrore e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare.
- II. I autorizuari obligohet ti përdorë vulat konform Ligjit për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës nr.03/L-054 në të kundërtën bartë përgjegjësi për keqpërdorim.
- III. Ky Vendimi hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me ketë vendim të njoftohet:

1. I autorizuari,
2. Arkivi komunal.





REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA	REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
02/Nr. Prot.	1-100/4231
Nr. ifaq.	1
Data	05.05.2024



REPUBLICA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/81

Datë: 15.05.2024

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nen 45 paragafi 1,2, 3 dhe 4 të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren (QRK) Nr. 05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores numër 15/2023, për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kryetari i Komunës me datë 15.05.2024 merr këtë:

V E N D I M

I. Themelohet komisioni i vlerësimit për pranim, për pozitën Zyrtar i Prokurimit RN00013779, në Komunën e Junikut .

II. Komisioni ka këtë përbërje:

1. Arton Krasniqi - Zv. Udhëheqës i Personelit - Kryesues i Komisionit;
2. Flurije Shehu -Kryeziu- Zyrtare e Lartë për Kadastër – anëtare;
3. Ferdone Tofaj- U.D Shefe e Sektorit në Urbanizëm- anëtare;
4. Saranda Isufaj- Udhëheqëse e Sektorit të Tatimit në Pronë – anëtare;
5. Avdyl Maloku- Zv. Çertifikues Aprovues - anëtar i komisionit.

III. Anëtarët e Komisionit Zëvendësues:

1. Valbona Gaxherri- Gacaferi – Udhëheqëse e sektorit në Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- Kryesuese e Komisionit;
2. Fatmir Hoti – Lektor anëtar;
3. Idriz Gacaferi – Inspektor i Ndërtimit –anëtar;
4. Sundim Krasniqi - U.D Shef i Sektorit të Gjendjes Civile –anëtar;
5. Bashkim Gaxherri- Zyrtarë për regjistrimin e pronave te paluajtshme- anëtar .

IV. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit janë të percaktuara sipas Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren (QRK) Nr. 05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Me ketë vendim të njostohen:

1. Zyra e personelit,
2. Anëtarët e komisionit,
3. Arkivi komunal.





REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA	1-180/4339
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
02/Nr. Prot.	1
Nr. i faq.	20/05/2024
Data	



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/82

Datë: 20.05.2024

Në mbështetje të nenit 39 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, të Republikës së Kosovës dhe në bazë Rregulloren (QRK) Nr. 05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores numër 15/2023, për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe kërkesës nga Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis, Kryetari i Komunës, me datë: 20.05.2024, merre këtë:

V E N D I M

- I. AUTORIZOHET Zyra e Personelit në Komunën e Junikut, për zhvillimin e Procedurave për pranimin në shërbimin civil, për pozitën Zyrtar i Lartë Ligjor, e planikuara me Planin e Personelit për vitin 2024.
- II. Zyra e Personelit është e obliguar që ti zbatoj të gjitha dispozitat ligjore të cekura me lartë në lidhje me autorizimin e cekur .
- III. Ky Vendim hyn ne fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me ketë vendim të njoftohet:

1. Zyra e personelit,
2. Drejtoria për UKM,
3. Arkivi komunal.





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA	KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot.	1-180/4335
Nr. i faq.	9
Data	20/05/2024



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr.01/83

Datë:20.05.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/I-040, GZRK 28/2008); nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.09.2010, nenit 7.1, 7.2 dhe nenit 8 të Ligjit Nr.02/L-111 për bletarinë dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 5/2008 për parandalimin, luftimin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive të bletëve, Kryetari i Komunës, me datë 20.05.2024 merr këtë:

VENDIM

I. Për emërimin e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për lëvizje të bletëve në këtë përbërje:

1. Avdyl Maloku - Kryesues i Komisionit
2. Tafë Tofaj - Anëtar
3. Baki Krasniqi - Anëtar

II. Obligohet Komisioni që të bëjë shqyrtimin e kërkesave të bletoreve për levizjen e bletëve nga komunat tjera në Komunën e Junikut, në fazen e lulezimit të gështënjes.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njostohen:

- Anëtarët e komisionit,
- Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

02/Nr. Prot. 1-180/4375

Nr. ifaq.

Data

22.05.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/84

Datë: 22.05.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 44 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe kërkesës me numër të prot. 01-155/4201 datës 14.05.2024 nga Operatori Ekonomik "Joos Krasniqi", Kryetari i Komunës me datë 22.05.2024 merr ketë:

V E N D I M

- I. Themelohet komisioni për vlerësimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe rrëshqitja e dheut në lokacionin Shkozë në parcelat P-73105038-00338-1, P-73105038-00344-0 të Komunës së Junikut.
- II. Komisioni përbëhet nga tre anëtarë:
 1. Shkelzen Shehu- Kryesues,
 2. Tafë Tofaj – anëtarë,
 3. Egronit Gaxherri – anëtarë.
- III. Komisioni do të hartoje raport të detajuar për vlerësimin e rrëshqitjes së dheut në lokacionin Shkozë në parcelat P-73105038-00338-1, P-73105038-00344-0 në Komunën e Junikut.
- IV. Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtareve të komisionit,
- Arkivit.





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

02/Nr. Prot. 1-180/6435
Nr. Ifaq. 1
Data 23/05/2024



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/85
Datë: 23.05.2024

Në bazë të nenit 13 të Ligjit per Vetqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.09.2010, Kryetari i Komunës së Junikut, me datë 23.05.2024, merr këtë:

V E N D I M


PËR CAKTIMIN E KOORDINATORIT TË PROCESIT DHE EMËRIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT PËR KOMUNËN E JUNIKUT PËR VITIN 2023

- I. Me këtë Vendim caktohet Koordinatori i procesit për çështje audituese dhe formohet Grupi Punues (GP) për hartimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit për Komunën e Junikut për vitin 2023, në këtë përbërje:
- | | |
|--|--------|
| 1. Arten Hamza, Zyrtar Kryesor Financiar, Koordinator i Procesit dhe Kryesues i Grupit Punues. | Anëtar |
| 2. Vjollca Qestaj, Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa | Anëtar |
| 3. Leonora Shehu , Drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, | Anëtar |
| 4. Arian Xhuli, Zyrtar për ndërtimtari- Menaxher i kontratave | Anëtar |
| 5. Zyra e prokurimit, Junik | Anëtar |
| 6. Zyrta i logistikës | Anëtar |
| 7. Zyrta për pasuri | Anëtar |
- II. Koordinatori i Procesit dhe GP kanë për detyrë të operojnë në përputhje me Procedurat Standarde të Operimit (PSO) – trajtimi i të gjeturave dhe zbatimi i rekomandimeve të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm nga Subjekti i Sektorit Publik (SSP) i audituar, aprovar nga Ministria e Financave.
- II. Ky Vendim hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit të tij.

Vendimi i dorëzohet

- Koordinatorit të procesit
- Anëtarëve të Grupit Punues
- Arkivit.





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/86

Datë: 06.06.2024

Në bazë në Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, nenit 13 Statutit të Komunës së Junikut nenit 43, dhe në mbështetje të Ligjit Nr.08/L-196 Për Pagat ne Sektorin Publik nisi 36 paragrafi 2 lidhur me nenparagrafët 2.3, Kryetari i Komunës me datë: 06.06.2024, merre këtë:

V E N D I M

Për pagesë retroaktive

- I. Për ndarjen e mjeteve vlerë prej 600.94 € për muajt mars, prill dhe maj 2024, bazuar në formularët për punën jashtë orarit për personal i autorizuar si ushtrues i detyrës zyrtar përgjegjës i prokurimit për kryerjen e punëve të përkohshme shtesë në Komunën e Junikut në bazë të marrëveshjes Nr.prot:1-180/2264 të datës : 12.03.2024 në mes të Komunës së Pejës dhe Komunës së Junikut.
- II. Shuma e përmendur në pikën I të këtij vendimi do të realizohet nga kategoria mallra dhe shërbime, dhe mjetet do te barten ne xhirollogarinë Nr.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim njoftohet :

- z. Sokol Katanolli;
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
- Zyra e Personelit;
- Arkivi komunal.





REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK / OPSTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

02/Nr. Prot. 1-180/477-
Nr. Faz. 9
Data 06/06/2024



REPUBLIKA E KOSOVES – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/87

Datë: 06.06.2024

Në baze të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 44 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe kërkesës me numër të prot. 01-180/4778 datës 04.06.2024 nga Operatori Ekonomik “Joos Krasniqi”, Kryetari i Komunës me datë 06.06.2024 merr ketë:

V E N D I M

- I. Themelohet komisioni Ad-hoc për shqyrtimin e kërkesës me numër të prot. 01-180/4778 datës 04.06.2024 nga Operatori Ekonomik “Joos Krasniqi” për verifikimin e rrezikut në lokacionin Shkozë në parcelat P-73105038-00338-1, P-73105038-00344-0 të Komunës së Junikut.
- II. Komisioni përbëhet nga tre anëtarë:
 1. Baki Krasniqi- Kryesues,
 2. Idriz Gacaferi – anëtarë,
 3. Turim Ganijaj – anëtarë.
- III. Komisioni do të harto raport të detajuar për verifikimin e rrezikut në lokacionin Shkozë në parcelat P-73105038-00338-1, P-73105038-00344-0 në Komunën e Junikut.
- IV. Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtareve të komisionit,
- Arkivit.





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

02/Nr. Prot. 1-980/6945
Nr. i faq. 9
Data 07/06/2024



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/88

Datë: 07.06.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); Ligji nr. 03/l-212 i punës, Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, nenit 43 dhe , Udhëzim Administrativ (mapl) nr. 01/2018 për caktimin e stafit mbështetës në komuna, neni 4, paragrafi 2 nenparografi 2.4, Kryetari i Komunës me datë: 07.06.2024, merr ketë:

V E N D I M

- I. Z. Burim Syla me Nr. personal. emërohet Zyrtar për Logistikë (Vozitës) në zyrën e kryetarit nga data 07.06.2024.
- II. Paga mujore e Zyrtarit për Logistikë (Vozitës) në Kabinetin e Kryetarit të Komunës së Junikut do të jetë sipas koeficientit 4 klasa C23 - sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik) në ngarkesë të linjës buxhetore të Zyrës së Kryetarit.
- III. Marrëdhënia e punës e Zyrtarit për Logistikë (Vozitës), pushon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës apo me ndonjë vendim tjetër nga Kryetari i Komunës.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

- I emëruari,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Zyra e Personelit,
- Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/89

Datë: 07.06.2024

Në bazë të ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L040, GZR 28/2008, nen 13), nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut, të datës 29.09.2010, vendimit të Kuvendit Komunal Nr. 2/180/4884 të datës 06.06.2024 dhe kërkesës me Nr. të protokollit 1-155/4899, të datës 06.06.2024 nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Kryetari i Komunës me datë: 07.06.2024, merr këtë:

V E N D I M

- I. Për formimin e grupit punues për plotësim ndryshimin e Normave Tatimore për vitin 2025.
- II. Grupi punues ka përbërje prej tre (3) anëtarëve si në vijim:
 1. Saranda Isufaj – Kryesuese e Grupit
 2. Arten Hamza – Anëtar
 3. Florant Pepshi – Anëtar
- III. Grupi punues, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi do të bëjë plotësim ndryshimet e nevojshme në Rregulloren Komunale për Pronën e Paluajtshme.
- IV. Vendimi hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- Zyra e Tatimit në Pronë
- Anëtarët e Grupit Kryetari i Komunës
- Arkivi





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK



Zyra e Kryetarit

Nr. 01/90

Datë: 07.06.2024

Në bazë të ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 13, Statutin e Komunës së Junikut neni 43, dhe në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal me Nr. 2/180/4883, të datës 06.06.2024, Kryetari i Komunës me datë 07.06.2024, merr këtë:

V E N D I M

- I. Për themelimin e grupit punues për plotësim/ndryshimin e Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale.
- II. Komisioni ka këtë përbërje si në vijim:
 1. Vjollca Qestaj- Drejtoreshë për BF - Kryesuese e Grupit punues,
 2. Arten Hamza- ZKF- Anëtar,
 3. Leonora Shehu- Drejtoreshë për A.P – Anëtare,
 4. Jetmir Jasiqi- Drejtor për ZH.E - Anëtar,
 5. Zenun Shala- Drejtor për U.K.M – Anëtar,
 6. Xhavit Velijaj - Drejtor për AKRS – Anëtar,
 7. Fatos Shala - Drejtor për SH.M.S -Anëtar,
 8. Demokrat Ganijaj – Drejtor për SH.P.I.M.SH – Anëtar,
 9. Klodiana Pepshi- Zyrtare për Arsim- Anëtare
 10. Saranda Isufaj- Menaxhere e Tatimit në Pronë -Anëtare,
 11. Esat Hoxha- Zyrtar për protokoll- Anëtar,
 12. Ferdone Tofaj- Zyrtare e Lartë për Urbanizëm -Anëtare,
 13. Ali Kuçi – U.D. Drejtor në QKMF – Anëtar,
 14. Flurije Shehu – Zyrtare e Lartë për Gjeodezi – Anëtare,
 15. Turim Ganijaj – Shef për Shërbime Publike – Anëtar
- III. Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të komisionit janë që të mbledhin informacione në fushat përkatëse sipas ligjeve në fuqi.



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
ROMUNA JUNIK/OPSTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

02/Nr. Prot. 1-180/5111
Nr. I Dq. 1
Data 12.106.2024



REPUBLIKA E KOSOVES – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/91

Datë: 12.06.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, njoftimin nga zyra e prokurimit të datës 10.06.2024, Kryetari i Komunës me datë: 12.06.2024, merre këtë:

VENDIM

- Për themelimin e komisionit për mbikëqyrjen e shërbimeve për aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e rrethojës së Dëshmorit Bashkim Leku", me numër të prokurimit 636-24-5465-2-4-7 dhe me numër të brendshëm 636-24-015-247.
 - Komisioni do të përbehet nga tre (3) anëtarë dhe përbërja e tij është si në vijim:
 - Turim Ganijaj - kryesues i komisionit;
 - Arian Xhuli - anëtarë i komisionit;
 - Baki Krasniqi - anëtarë i komisionit.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me ketë vendim të njoftohet:

- Drejtoria e Shërbimeve Publike;
- Zyra e Prokurimit;
- Anëtaret e Komisionit;
- Arkivi komunal.





REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA	REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPSTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
QJ/In. Prot.	1-180/5127
Nr. Ifaq.	9
Data	12/06/2024



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/92

Datë: 12.06.2024

Në mbështetje të nenit 39 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, të Republikës së Kosovës dhe në bazë të nenit 4 paragrafi 1 dhe nenit 15 i Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe kërkesën me numër të protokollit 1-155/4230 të datës 15.05.2024 nga Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim Kryetari i Komunës, me datë: 12.06.2024, merre këtë:

V E N D I M

- I. AUTORIZOHET Zyra e Personelit në Komunën e Junikut, për zhvillimin e Procedurave për pranimin në shërbimin civil, për pozitën e planifikuara Zyrta për Bujqësi dhe Zhvillim Rural me Planin e Personelit për vitin 2024.
- II. Zyra e Personelit është e obliguar që ti zbatoj të gjitha dispozitat ligjore të cekura me lartë në lidhje me autorizimin e cekur .
- III. Ky Vendim hyn ne fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me ketë vendim të njoftohet:

1. Zyra e personelit,
2. Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim,
3. Arkivi komunal.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/93

Datë: 12.06.2024

KOMUNA JUNIK / OPŠTINA JUNIK / MUNICIPALITY OF JUNIK

02/Nr. Prot.

Nr. ifaq.

Data

1-180/5149

1

12.06.2024

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr. 03/L/040, GZRK 28/2008, nenit 10 pika R dhe nenit 43 të statutit të Komunës Së Junikut të datës: 29.10.2010, Kryetari i Komunës së Junikut merr këtë:

VENDIM

I. Themelohet Grupi Punues për organizimin e koktej dhe koncertit për bashkatdhetarët, në këtë përbërje:

1. Vjollca Qestaj - Kryesuese
2. Leonora Shehu - Anëtar
3. Zeqë Hebibi - Anëtar
4. Jetmir Jasiqi -Anëtar
5. Demokrat Ganijaj - Anëtar
6. Rrustem Pepshi – Anëtar
7. Artan Krasniqi - Anëtar

II. Grupi punues ka për detyrë që të merret me organizimin dhe mbarëvajtjen e koktejit dhe koncertit për bashkatdhetarët.

III. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i dërgohet:

1. Anëtarëve të Grupit Punues,
2. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe
3. Arkivit.

Kryetari i Komunës

Ruzhdi Shehu





REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA	REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPSTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
02/Nr. Prot.	01/180-5228
Nr. Ifaq.	1
Data	18/06/2024



REPUBLIKA E KOSOVES – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/94

Datë: 18.06.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 43 i Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, neni 3 i Rregullores (QRK) Nr. 25/2020, për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë, Kryetari i Komunës me datë: 18.06.2024, merr ketë:

V E N D I M

I. Formimin e Grupit punues për Rifreskimin e Planit për Vlerësimin e Rrezikut në territorin e Komunës së Junikut, me këtë përbërje :

1. Shkëlzen Shehu – Komandant i Njësisë së Zjarrfikësve dhe Zyrtar për Gatishmëri dhe Emergencë - Kryesues;
2. Arian Xhuli – Zyrtar për Ndërtimtari - anëtar,
3. Bashkim Gaxherri – Zyrtar Administrative, dhe Regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme – anëtar;
4. Valbona Gaxherri Gacaferi – Udhëheqës e Sektorit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, anëtare;
5. Idriz Gacaferi – Inspektor i Ndërtimit anëtar;
6. Demokrat Ganijaj- Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Inspeksion - anëtar;
7. Turim Ganijaj – Udhëheqës i Sektorit për Sh. Publikë – anëtar;
8. Avdyl Maloku- Zv. Çertifikues Aprovues- anëtar;
9. Jetmir Jasiqi- Drejtor për Zhvillim Ekonomik- anëtar;
10. Florant Pepshi- Shef i sektor për Buxhet- anëtar;
11. Ali Kuqi- Ud. Kryeshef i QKMF-së;
12. Aziz Miroci- Infermier në QKMF- anëtar;
13. Bekim Gaxherri – Përfaqësues i Shoqërisë Civile- anëtar;
14. Tafë Gaxherri- Hidrodrini- anëtar;
15. Arbër Gjota- Komuniteti Lokal për Siguri Publike- Junik (KLSP)- anëtar;
16. Rasim Syla- Komandant i stacionit policor në Junik – anëtar;
17. Violeta Kukalaj- Kryqi i Kuq- anëtare.

II. Përgjegjësit e Grupit punues janë të përcaktuara me Rregullores (QRK) Nr. 25/2020, për Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë.

III. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës

Me ketë vendim njoftohen:

- Anëtaret e Grupit;
- Arkivi i Komunës.





REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA	REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
02/Nr. Prot.	01-180-5232
Nr. Ifaq.	1
Data	18.06.2024



REPUBLICA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/95

Datë: 18.06.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.09.2010, Kryetari i Komunës së Junikut merr këtë:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E KOMISIONIT PËR PRANIMIN E PUNËVE TË KRYERA

- I. Me këtë vendim emërohen anëtarët e komisionit për pranimin e punëve të kryera për projektin: “Ndërtimi i Qendrës për Kulturë, Turizëm dhe Agrobiznes”, prej tre anëtarëve:
 1. Arian Xhuli – Kryesues
 2. Ferdone Tofaj – anëtare
 3. Sundim Krasniqi – anëtar
- II. Obligohet komisioni që të bëjë verifikimin e punimeve të kryera, si dhë të hartoj raportin përfundimtar të punëve të kryera të projektit të lartcekur.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

- Anëtarët e Komisionit
- Arkivi Komunal





REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

02/Nr. Prot. 01-180-5239
Nr. Ifaq. 18106/2024
Data 18/06/2024



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/96

Datë: 18.06.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, Kërkeses me numer të protokolit 1-155/5124, të datës 12.06.2024, Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës me datë: 18.06.2024, merr këtë:

V E N D I M

- I. Emerohet komisioni i pranimit teknik të punimeve në projektin Rregullimi i hapësirave sportive, rekreative dhe të ambientit në shkollën fillore "Edmond Hoxha" me numër 636-23-10824-5-3-6 dhe me numër të brendshëm 636-23-043-536.
- II. Komisioni ka përberje prej tre (3) anëtarëve si në vijim:
 1. Arian Xhuli – Kryesues,
 2. Fatmir Goçi – anëtar,
 3. Musa Krasniqi – anëtar.
- III. Obligohet komisioni që të bej vleresimin konform paramases dhe paralogarisë në projektin Rregullimi i hapësirave sportive, rekreative dhe të ambientit në shkollën fillore "Edmond Hoxha" me numër 636-23-10824-5-3-6 dhe me numër të brendshëm 636-23-043-536, në bazë të të cilit do të paraqes Raport me shkrim.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

- Anëtaret e Komisionit,
- Zyra e Prokurimit,
- Drejtori i Drejtorisë përkatëse,
- Arkivi.

Kryetari i Komunës
z. Ruzhdi Shehu





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/97

Datë: 21.06.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, neni 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës me datë: 21.06.2024, merr këtë:


V E N D I M

- I. Për bashkëfinancim të organizimit “Takimet ndërkombëtare – Ditët e Gjeravicës 2024”, bazuar në kërkesën me nr. 1-155/4712 të datës 03.06.2024 nga Shoqata Bjeshkatare “Rrasa e Zogut” Junik.
- II. Sipas këtij vendimi Komuna merr përsipër mbulimin e shpenzimeve të derivateve për organizimin e transportit dhe shpenzimet e darkës në ditën e parë të organizimit me datën 22.06.2024 të cilat do të mbulohen nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.
- III. Shoqëria Bjeshkatare “Rrasa e Zogut” merr përsipër mbulimin e shpenzimeve tjera të organizimit, siç janë: Akomodimi, sigurimi i materialit punues, higjenik dhe materialit shpenzues, sigurimin e karrikave dhe tavolinave, sigurimin e Muzikës dhe teknikes përcjellëse, sigurimin e ndriçimit dhe sigurimin e ushqimit dhe pijeve për mëngjes dhe drekë në ditën e dytë me datën 23.06.2024.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

- Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik;
- Shoqëria Bjeshkatare “Rrasa e Zogut”;
- Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/98

Datë: 24.06.2024

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nen 45 paragrafi 1,2, 3 dhe 4 të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren (QRK) Nr. 15/2023, për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kryetari i Komunës me datë 24.06.2024 merr këtë:

V E N D I M

- I. Themelohet komisioni i vlerësimit për pranim, për pozitën Zyrtar i Lartë Ligjor RN00014073, në Komunën e Junikut .
- II. Komisioni ka këtë përbërje:
 1. Arton Krasniqi - Zv. Udhëheqës i Personelit - Kryesues i Komisionit;
 2. Flurije Shehu –Kryeziu- Zyrtare e Lartë për Kadastër – anëtare;
 3. Ferdone Tofaj- U.D Shefe e Sektorit në Urbanizëm- anëtare;
 4. Ariola Krasniqi- Zyrtare e Lartë për Buxhet dhe Financa -anëtare e komisionit;
 5. Egronit Gaxherri- Zyrtar i Teknologjisë Informative- anëtar i komisionit.
- III. Anëtarët e Komisionit Zëvendësues:
 1. Saranda Isufaj- Udhëheqëse e Sektorit të Tatimit në Pronë - Kryesuese e Komisionit;
 2. Haxhë Qestaj – Zyrtar i Gjendjes Civile -anëtar;
 3. Iliriana Isufaj- Zyrtare për Procedimin e të dhënavë- anëtare e komisionit;
 4. Sundim Krasniqi - U.D Shef i Sektorit të Gjendjes Civile –anëtar;
 5. Bashkim Gaxherri- Zyrtarë për regjistrimin e pronave te paluajtshme- anëtar .
- IV. Detyrat dhe përgjegjësítë e komisionit janë të percaktuara sipas Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Me ketë vendim të njoftohen:

1. Zyra e personelit,
2. Anëtarët e komisionit,
3. Arkivi komunal.





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/99

Datë: 25.06.2024

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr.03-L/040, në bazë Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 40 të Ligjit të punës nr. 03/L-212, nenit 15 pika 1-5 të Rregullores nr.04/2024 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë si dhe kërkesës së nëpunëses Adelina Alija të datës 11.06.2024 me numër të protokollit 8-155/5076 , Kryetari i Komunës me datë: 25.06.2024 merr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e znj. Adelina Alija – Laborante në QKMF Komuna Junik, për marrjen e pushimit pa pagesë në periudhë prej gjashtë (6) muaj.
- II. Për kohën e mungesës në punë pa kompensim të pagës nga paragrafi I. i këtij Vendimi, të punësuarës i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përvèç të drejtave të cilat burojnë nga pagesa e detyrueshme e kontributive nga ana e të punësuarës.
- III. Pushimi pa pagesë do të filloj prej datës: 01.07.2024 deri me 31.12.2024, e përmendura duhet të lajmërohet ne punë me datë: 01.01.2025.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me ketë vendim të njoftohet:

1. Pala,
2. Drejtoria për SHMS,
3. Zyra e personelit,
4. Arkivi komunal.

Kryetari i Komunës
z. Ruzhdi Shehu

JUNIK



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPSTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

02/Nr. Prot. A-180-5432
Nr. I fag.
Data 26/06/2024



REPUBLICA E KOSOVES – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/100

Datë: 26.06.2023

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, nenit 43 te Statusit të Komunës së Junikut, Rregulloren Nr. 02-180-9082 të datës 06.11.2018 për Kushtet, Kriteret dhe procedurat e Ndardjes së Subvencioneve, Kryetari i Komunës me datë : 26.06.2024, bie ketë:

V E N D I M

- I. Për themelimin e komisionit të përkohshëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve në Sektorin e Kulturës, Rinis dhe Sportit.
 1. Arton Krasniqi– Kryesues i komisionit,
 2. Klodianë Pepshi – anëtare,
 3. Saranda Isufaj– anëtare
 4. Haxhë Qestaj – anëtarë,
 5. Egronit Gaxherri – anëtarë.
- II. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit janë te përcaktuara me Rregulloren Nr. 02-180-9082 të datës 06.11.2018, për Kushtet, Kriteret dhe procedurat e Ndardjes së Subvencioneve.
- III. Ky Vendim hyn ne fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me ketë vendim njoftohen:

- Anëtaret e komisionit,
- Arkivi komunal.

**Kryetari i Komunës
z. Ruzhdi Shehu**





REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK / OPŠTINA JUNIK / MUNICIPALITY OF JUNIK

OZ/Nr. Prot. 1-18015478
Nr. Flak. 1
Data 27.06.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/101

Datë: 27.06.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008), Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, nenit 43, Kryetari i Komunës me datë: 27.06.2024, merr ketë:

VENDIM PËR AUTORIZIM

- I. Autorizohet z. Egronit Gaxherri i emëruar në vendin e punës Zyrtar i IT-së në Drejtorinë e Arsimit, që të ushtroj detyrën si UD. Udhëheqës i Prokurimit.
- II. I emëruari në pikën një (I) të këtij vendimi në bazë të certifikimit nga ana e KRPP-së do të ushtroj këto autorizime duke filluar nga data 01.07.2024.
- III. Për ekzekutimin e këtij Vendimi kujdeset, Zyra e Kryetarit dhe Zyra e personelit në Komunën e Junikut.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

- Z. Egronit Gaxherri,
- Zyra e Personelit,
- DBF
- Arkivi.

Kryetari i Komunës

z. Ruzhdri Shehu





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA	REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
02/Nr. Prot.	01-180-5476
Nr. i faq.	
Data	27.06.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/102

Datë: 27.06.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligi Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008), Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.09.2010, nenit 43, Kryetari i Komunës me datë: 27.06.2024, merr ketë:

VENDIM PËR AUTORIZIM

- I. Autorizohet z. Imer Gjota i emëruar në vendin e punës Zyrtar i prokurimit në kuadër të zyrës së Kryetarit, autorizohet për kryerjen e detyrate brenda zyrës së prokurimit si Zyrtar për nxjerrjen e Urdhër Blerjeve në Komunën e Junikut
- II. I emëruari në pikën një (I) të këtij vendimi në bazë të akt emërimit të datës 18.06.2024 do të ushtroj autorizime bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë me kompetenca të plota.
- III. Për ekzekutimin e këtij Vendimi kujdeset, Zyra e Kryetarit dhe Zyra e personelit në Komunën e Junikut.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

- z. Imer Gjota
- Zyra e Personelit,
- DBF
- Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA	REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNKI/OPŠTINA JUNKIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
02/Nr. P.oz.	01-180-3477
Nr. I faq.	
Data	27/06/2024



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNKIK – OPŠTINA JUNKIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/103

Datë: 27.06.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008), Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.09.2010, nenit 43, Kryetari i Komunës me datë: 27.06.2024, merr ketë:


VENDIM PËR AUTORIZIM

- I. Autorizohet znj. Lindita Shehu e emëruar në vendin e punës Zyrtare për pasuri, në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme, që të ushtroj detyrën me kompetenca të plota në modulin e pasurisë në SIMFK.
- II. E emëruara në pikën një (I) të këtij vendimi do të ushtroj këto autorizime duke u bazuar në legjislativën në fuqi.
- III. Për ekzekutimin e këtij vendimi kujdeset, Zyra e Kryetarit dhe Zyra e personelit në Komunën e Junikut.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

- znj. Lindita Shehu,
- Zyra e Personelit,
- DBF
- Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/104

Datë: 03.07.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, neni 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës me datë: 03.07.2024, merr ketë:

V E N D I M

- I. Formimi i Grupit punues për Hartimin e planit nder komunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave, me këtë përbërje :
 1. Demokrat Ganijaj- Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Inspeksion - Kryesues;
 2. Turim Ganijaj – Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publikë – anëtar;
 3. Baki Krasniqi- Inspektor komunal – anëtar;
 4. Idriz Gacaferi – Inspektor i Ndërtimit anëtar;
 5. Rrustem Pepshi- Udhëheqës i Sektorit për Teknologji Informative-Logistikë anëtar;
 6. Arten Hamza– Zv. Udhëheqës i Financave- ZKF- anëtar.
- II. Përgjegjësit e Grupit punues janë të përcaktuara me legjisacionin në fuqi.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës

Me ketë vendim njoftohen:

- Anëtaret e Grupit;
- Arkivi i Komunës.





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA	KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot.	1-986/5626
Nr. Ifaq.	2
Data	03/07/2024



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/105

Datë: 03.07.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 44 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Shkresës njoftuese të datës 27.12.2023 DMZP, Kryetari i Komunës me datë 03.07.2024 merr ketë:

V E N D I M


I. Për plotësim – ndryshimin e grupit punës për hartimin e Rregullores për organizimin e brendshëm, klasifikimin dhe sistematizimin e vendeve të punës si dhe riorganizimin e administratës komunale me përbërje si në vijim:

1. Arton Krasniqi kryesues;
2. Vjollca Qestaj – anëtare;
3. Leonora Shehu – anëtare;
4. Zenun Shala- anëtar;
5. Xhavit Velijaj- anëtar;
6. Fatos Shala- anëtar;
7. Demokrat Ganijaj- anëtar;
8. Jetmir Jasiqi- anëtar;
9. Flurije Shehu Kryeziu- anëtare;
10. Ferdone Tofaj- anëtare;
11. Arten Hamza- anëtar;
12. Lindita Shehu- anëtare.

II. Detyrat dhe përgjegjësit e Grupit Punues janë:

2.1 Analizim I gjendjes aktuale të administratës komunale dhe legjislativës përkatës lidhur me organizimin e brendshëm të strukturave, njësive organizative të administratës komunale, hierarkinë dhe përgjegjësit e tyre.

2.2 Klasifikimin i vendeve të punës sipas faktorëve të klasifikimit të përcaktuar me rregulloren (QRK) Nr. 10/2022, për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbim Civil.



REPUBLIKA E KOSOVES – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/106

Datë: 04.07.2024

Në bazë në nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, nenit 43 Statutit të Komunës së Junikut, Ligjit Nr.05/L-03 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 4, 5 dhe neni 44, dhe në bazë të kërkesës së datës 31 maj 2024, Kryetari i Komunës me datë 04.07.2024, merr këtë:

VENDIM

- I. Ndryshohet dhe plotësohet vendimi i datës 15.12.2022 me nr të protokollit 1-180/1192.
- II. APROVOHET kërkesa e datës 31.05.2024, nga z.Xhavit Gaxherri – Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve – Kryesues i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve - Junik.
- III. Komisioni Komunal i Zgjedhjeve do të ketë të drejtën e shfrytëzimit të hapësirave të objektit të shkollës numër një (zyrës së drejtorit të shkollës, zyrës së sekretarit dhe sallën e arsimtarëve).
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

- I lartëcekuri,
- Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit
- Arkivi.





KOJATI I KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK / MUNICIPALITY OF JUNIK

DD/Nr. 130
No. 130
Data: 05/07/2024

1-130/5800



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/107

Datë: 04.07.2023

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); Ligji nr. 03/l-212 i punës, Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, Ligjit për zyrtarët publik nr 08/L-197 neni 60 paragrafi 1,2 dhe 3, neni 10 i Rregullores nr. 01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil, Kryetari i Komunës me datë: 04.07.2024, merr ketë:


VENDIM
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E KOMISIONIT DISIPLINOR

- I. Me ketë Vendim ndryshohet dhe plotësohet përbërja e komisionit disiplinor në Komunën e Junikut i themeluar sipas Vendimit Nr. 01/61, i datës 10.07.2023, si në vijim:
 1. Arton Krasniqi –Zv. Udhëheqës i Personelit - Kryesues i komisionit;
 2. Ferdone Tofaj – U.D. Shefe e sektorit për Urbanizëm – Anëtare;
 3. Flurije Shehu Kryeziu -Zyrtare e lartë për kadastër – Anëtare.
